



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA VI

Sesioni vjeshtor

Komisioni për Integritet Evropian

Mbledhja nr. 9

Prishtinë, më 22.12.2017, në ora 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-204

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Blerta Deliu-Kodra, Zenun Pajaziti, Fitore Pacolli, Ilir Deda, Armend Zemaj, Adem Hoxha, Ahmet Isufi, Fikrim Damka, Fatmire Kollçaku dhe Milaim Zeka.

Mungoi: Glauk Konjufca.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Ahtere Loxha, Safet Beqiri dhe Florent Mehmeti.

Të ftuar: Flamur Sefaj, ministër i Punëve të Brendshme, me përfaqësuesit të Policisë së Kosovës .

Pjesëmarrës të tjerë: përfaqësuesi nga GLPS, GIZ, OSBE, NDI, KDI dhe mediat.

Mbledhjen e kryesoi, znj. Blerta Deliu- Kodra, kryetare e komisionit.

Kryetarja, Blerta Deliu- Kodra, pasi konstatoi se janë plotësuar kushtet për punë e hapi mbledhjen e komisionit me këtë

Rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e datës 7.11.2017 dhe 13.11.2017;
3. Raportim i z. Flamur Sefaj, ministër i Punëve të Brendshme, lidhur me përmbushjen e obligimeve, në kuadër të agjendës evropiane;
4. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-019 për Standardizim, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;
5. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e datës 7.11.2017 dhe 13.11.2017

Procesverbalet nga mbledhjet e dt. 7.11.2017 dhe 13.11.2017, u miratuan pa vërejtje.

3. Raportim i z. Flamur Sefaj, ministër i Punëve të Brendshme, lidhur me përmbushjen e obligimeve, në kuadër të agjendës evropiane

Kryetarja, fillimisht falënderoi ministrin për përgjigjen në ftesën për raportim para komisionit dhe tha se qëllimi i takimit ishte informimi i komisionit lidhur me përmbushjen e agjendës evropiane nga Ministria e Punëve të Brendshme, pra janë obligime që kanë dalë nga Plani Kombëtar për zbatimin e MSA-së, menaxhimin e integruar të kufirit, për sigurinë, si dhe rreth punëve të brendshme në Kosovë, në përgjithësi.

Ministri Flamur Sefaj, falënderoi për ftesën dhe e konsideroi nder të madh të vijë para komisionit, të raportojë për të arriturat dhe obligimet rreth zbatimit të Planit Kombëtar të MSA-së për vitin 2017.

Në kuadër të PKZMA-së për vitin 2017, tha se Ministria e Punëve të Brendshme ka planifikuar gjithsej 98 masa, nga të cilat 14 janë masa legislative dhe 84 janë masa zbatuese, 2 masa janë planifikuar në kapitullin 14: Politika e transportit, në kapitull janë planifikuar 7 masa: Gjyqësori dhe të drejtat themelore 23; në kapitullin 24- Drejtësia, liria dhe siguria, janë planifikuar 88 masa dhe 1 masë është planifikuar në kapitullin 27: Mjedisi.

Gjatë periudhës 1 janar- 15 dhjetor 2017, nga 14 masat legislative të planifikuara nga Ministria e Punëve të Brendshme, në kuadër të PKZMSA-së për vitin 2017, 5 masa janë përfunduar, kurse 9 masa të tjera janë në realizim e sipër, mirëpo me vonesa. Ndërsa, nga 84 masat zbatuese të planifikuara, 72 masa janë përfunduar dhe 12 masa janë në realizim e sipër, me vonesa të vogla.

Prej 84 masave zbatuese të planifikuara në kuadër të PKZMSA-së, 45 janë masa që adresohen në vazhdimësi dhe raportohen përmes të dhënave statistikore, andaj konsiderojmë se janë përmbushur.

Në përgjithësi, nga 98 masat për të cilat Ministria e Punëve të Brendshme është përgjegjëse, deri më tani 77 (80%) masa janë përfunduar, ndërsa 21 (20%) janë në realizim e sipër.

Në fillim të muajit tetor është raportuar për tremujorin e tretë rreth zbatimit të PKZMSA-së 2017. Nga muaji shtator ka filluar procesi i rishikimit dhe është finalizuar

hartimi i PKZMSA-së për vitin 2018, në harmoni të plotë me Planin vjetor të punës së Ministrisë së Punëve të Brendshme.

Në vazhdim, paraqiti **pasqyrë të detajuar rreth progresit në zbatimin e masave në kuadër të PKZMSA-së (janar- 15 dhjetor 2017).**

Nga 14 **masat legislative** të planifikuara nga Ministria e Punëve të Brendshme, në kuadër të PKZMSA-së për vitin 2017, janë përfunduar 5 masa, ndërsa 9 masa janë në realizim e sipër, mirëpo me vonesa.

Tek masat, masat zbatuese, theksoi se në fushën e **menaxhimit të integruar të kufirit** janë paraparë gjithsej 16 masa zbatuese, prej tyre 13 masa janë realizuar, ndërsa 3 masa janë në realizim e sipër, me vonesa të vogla.

Në fushën e **sigurisë së dokumenteve** janë paraparë gjithsej 3 masa, të cilat ndërlidhen me pjesën e zbatimit në praktikë dhe adresohen në vazhdimësi dhe raportohen përmes të dhënave statistikore.

Në fushën e **azilit dhe migracionit**, nga 26 masa të parapara në fushën e azilit dhe migracionit, 25 masa janë zbatuar, ndërsa 1 masë është në realizim e sipër.

Në fushën e **shpëlarjes së parave dhe financimit të terrorizimit**, 5 masat e planifikuara janë përfunduar.

Në fushën e luftës **kundër narkotikëve**, 4 nga 5 masat e planifikuara, janë përfunduar.

Në fushën e luftimit të **krimin të organizuar dhe bashkëpunimi policor**, nga 13 masat e planifikuara, 10 masa janë përfunduar, ndërsa 3 masa janë në realizim e sipër.

Në fushën e **luftimit të terrorizmit**, 4 nga 8 masat e planifikuara, janë përfunduar.

Kurse, në kapitujt tjerë të PKZMSA-së, tha se janë planifikuar 10 masa, prej tyre 8 janë përfunduar, ndërsa 2 janë në realizim e sipër.

Në fushën e politikave të transportit, janë përfunduar 2 masat e planifikuara.

Në fushën e gjyqësorit dhe të drejtave themelore janë përfunduar 6 nga 7 masat.

Në fushën e politikave të mjedisit, 1 masë e planifikuar është në realizim e sipër.

Kryetarja e pyeti ministrin: cilat janë dhe do të jenë sfidat e Ministrisë së Punëve të Brendshme në zbatimin e masave të MSA-së në vitin 2018? Në vazhdim, tha se do të ndalem në reformat policore, cilat janë përpjekjet e ministrisë për formimin e një policie profesionale, plotësisht të pavarur dhe të specializuar, pastaj cilat janë masat konkrete të ministrisë në luftën kundër terrorizmit, trafikimit me qenie njerëzore dhe luftës kundër narkotikëve? Sepse, kemi pasur disa raste në shkolla fillore në shfrytëzim të narkotikëve nga nxënësit, cilat janë planet e ministrisë për ta luftuar këtë dukuri, që të mos jetë fare pjesë e shoqërisë sonë?

Ilir Deda, tha se do të fokusohet në një çështje e cila është mjaft e ndjeshme. Në Kosovë jetojnë qindra e qindra qytetarë të Luginës së Presheves, të cilët nuk mund të pajisen me dokumente personale, për shkak të situatës specifike në të cilën ndodhen ata, sepse ata jetojnë në Kosovë e jo në Serbi. Në vitet e fundit, ata shlyhen nga librat amzë në Republikën e Serbisë dhe kriteret e përcaktuara në Ligjin për shtetësi janë të vështira dhe nuk mund të zbatohen nga ata, sepse ata duhet të kenë letërnjoftim apo pasaportë valide të Serbisë, të cilën nuk mund ta marrin dhe kështu kanë mbetur

qytetarë pa shtetësi, andaj cila është mundësia ligjore apo ndërhyrja në ligj, që kjo çështje të rregullohet? Po ashtu, kërkoj që të bashkëpunojë komisioni ynë me ju, dhe nëse është e nevojshme që ne të iniciojmë plotësim-ndryshimin e ligjit apo nëse ka mundësi që me ndonjë vendim të Qeverisë apo ministrisë, të zgjidhet ky problem.

Ahmet Jusufi, pyeti ministrin lidhur me menaxhimin e integruar të kufirit. Ai tha se kur kemi parasysh lëvizjen e lirë të qytetarëve, në vendet fqinje, ka nevojë për një angazhim në këtë drejtim.

Po ashtu, kërkoi informacion për dy raste: 1. Lidhur me pikën kufitare në Stanqiq, që është lidhje mes Gjilanit dhe Kumanovës, a ka ndonjë lëvizje në këtë drejtim, që qytetarët mos të shkojnë së pari në Shkup për të shkuar në Kumanovë, por ta kenë lidhjen e drejtpërdrejtë, dhe e dyta, për pikën kufitare në Kapi të Sforcës, që lidh Medvegjën me Komunën e Dardanës. Ne, si deputetë e kemi vizituar atë pikë dhe komandanti i policisë na ka thënë se çështja është e KEK-ut, që nuk ka ofruar trafostacionin atje dhe nuk ka rrymë, dhe për shkak të rrymës, nuk ka lëvizje të lirë atje, kurse nga pala serbe na është thënë atje se ata janë të gatshëm, por problemi është te rryma.

Milaim Zeka, tha se kishte dy çështje për t'i diskutuar: e para, edhe në Kuvend është ngritur çështja e regjistrimit të makinave. Pra, kemi një statistikë që thotë se mbi 25% e makinave që qarkullojnë në territorin e Kosovës, janë të paregjistruara dhe nuk e di sa jeni të njoftuar se edhe në rast se ndodhin aksidentet në Kosovë, p.sh. nëse dikush është pa patentë shofer dhe ndodh aksidenti, faji mbetet tek ai që është me patentë shofer.

Kurse, çështja e dytë, tha se është shqetësim që qytetarët e Kosovës janë të privuar nga e drejta e tyre elementare nga Policia e Kosovës, gjatë marrjes në pyetje, edhe pse ligji ua garanton që çdo qytetar që merret në pyetje, në mënyrë automatike mund ta marrin një kopje nga procesverbali, se çka ka deklaruar në polici, por policia refuzon t'u japë një kopje. Ajo kopje pastaj mund të ndryshohet dhe të deformohet dhe të zhduket nga ana e hetuesve, gjë që ka ndodhur në plot raste. Andaj, pyetja është, çka keni bërë në këtë drejtim?

Fikrim Damka, ngriti çështjen e kosovarëve që jetojnë në Turqi. Ai tha se ka shumë prej tyre që e kanë nënën ose babanë kosovar, dhe sipas ligjit tonë, kanë të drejtë ta fitojnë shtetësinë e Kosovës, por prej shumë aplikuesve, me qindra janë refuzuar, pa bazë. Ka raste që 3 vëllezër i kanë prindërit kosovarë, dy e kanë marrë shtetësinë e Kosovës, kurse të tretit i është refuzuar.

Tani, në këtë kohë, kur shumë po e lënë shtetësinë e Kosovës, do të ishte mirë që udhëzimet administrative të shikohen më mirë dhe t'ju mundësojnë njerëzve të kenë moralisht shtetësinë e Kosovës, e jo për përfitime. Disa herë e kemi ngritur këtë çështje edhe në Kuvend, me pyetje kuvendare, andaj kërkoj nga ministri ta kenë parasysh këtë çështje.

Fatmire Kollçaku, tha se neve na e keni paraqitur raportin me masat që i keni ndërmarrë dhe ne nuk presim që t'i përmbushni në 100 ditësh-in e parë të gjitha ato nga plani qeverisës, mirëpo do të diskutoj lidhur me menaxhimin e situatave, sepse një

situatë e krijuar para deputetëve të Republikës së Kosovës, gjatë atestimit të deputetëve të këtij Kuvendi, ishte një situatë shumë e rëndë, sepse nuk duhet të arrestohen deputetët në tempullin e popullit. Pra, me siguri ka pasur mundësi që të menaxhohet situata ndryshe dhe mos të ketë pakënaqësi te qytetarët, sepse ju jeni të vetëdijshëm ministër, se të gjithë nuk jemi të barabartë para ligjit, sepse ka drejtësi selektive, përkundër faktit që në gjykatë është dashur të shkojnë edhe individët tjerë, që janë plotësisht të barabartë, por për ta nuk respektohen masat e njëjta. E di që shumë punë tuajat varen nga gjyqësori dhe prokuroria, por ju bëjë thirrje të punoni të pavarur nga politika. Ne dëshirojmë që kur e shohim policin tonë, ta ndiejmë një afërsi dhe respekt që vjen nga puna e pavarur nga politika.

Më intereson edhe çështja e narkotikeve, sepse pranë institucioneve shkollore ka raste që shihen fëmijët duke abuzuar me narkotikë. Ata janë të pavetëdijshëm për atë që bëjnë, por janë fajtorë narkodilerët, të cilët sillen lirshëm pranë shkollave, është detyrë e policisë që seriozisht ta marrin këtë problem.

Çështje tjetër, është edhe problemi i prostitucionit që është një dukuri mjaft e përhapur në Kosovë, po që nuk e di a është një mbyllje sysh para një dukurie të tillë, sepse në ato lokale ku ushtrohet prostitucioni, janë me emra të ndryshëm, duke filluar me masazh dhe emra të tjerë dhe nuk është e mundur që një polici e organizuar mirë dhe ministri që funksionon mirë, mos të këtë njohuri që kjo dukuri po zhvillohet aq shumë.

Andaj, pasi nuk po kemi rast shpesh që të takohemi, edhe një herë ftoj për drejtësi për të gjithë qytetarët dhe siguri në burgje, sepse nuk e dimë se çka po ndodh aty, sepse e dini se një aktivist i Lëvizjes Vetëvendosje ka vdekur në rrethana ende të pasqaruara dhe ende nuk është zbardhur rasti dhe të gjithë janë duke pritur të zbardhet, andaj keni sfida të mëdha para vetes dhe qytetarët e Kosovës i kanë sytë nga ju, që me punë të nderhme dhe larg duart nga politika, do të jeni ata që do ta krijoni besimin te qytetarët.

Adem Hoxha, tha se vij nga Dragashi, nga komuniteti goran dhe kemi mjaft probleme, kur është në pyetje siguria nga policia, sepse hiç më vonë se mbrëmë, ka pasur të shtëna në pompë të benzinës në Glloboçicë. Pra, është një sfidë dhe kërkesë që të shihet se policia nuk duhet të punojë në mënyrë selektive, sepse aty jeton komuniteti goran dhe kufiri është i hapur më se 70 km në gjerësi dhe nuk ka policë të mjaftueshëm. Fshati Restelicë ka vetëm një polic dhe nuk kemi stacion policor, kemi kërkesë që të hapet kufiri me Maqedoninë, që ka ekzistuar edhe më parë. Kam biseduar me krerët shtetërorë për këtë çështje dhe kam marrë premtime dhe ju lus që të mos ketë ndarje, vetëm me një përkatësi etnike. Para vetës keni një sfidë që t'i bashkoni dhe njerëzit të ndihen të njëjtë, sepse Kosova e ka synim integrimin evropian. Shpresoj që së bashku, së shpejti do të shkojmë dhe të vërtetojmë gjithë atë që thashë dhe të hapim edhe 3 ose 4 punkte policore rreth kufirit shqiptar dhe maqedonas.

Fitore Pacolli, tha se i bashkëngjitet kërkesës së deputetes Kollçaku, sepse është shumë e padrejtë, nëse deputetët e Lëvizjes Vetëvendosje, në momentin kur nuk paraqiten në polici, jepet urdhër për arrest, por kur të tjerët, si rasti me z. Kadri Veselin, që nuk paraqitet në gjykatë, nuk arrestohet, shtyhet seanca dhe mbyllen dyert për gazetarë, me

kërkesë të tij. Kjo është e padrejtë dhe kjo është qasje jo e barabartë ndaj qytetarëve të Kosovës.

Në vazhdim, pyeti ministrin: çka keni bërë si MPB dhe polici ndaj sulmeve të shpeshta që janë bërë ndaj gazetarëve? Ne mund të flasim për masat që janë ndërmarrë dhe janë realizuar sa i përket integritetit në BE, por e dini se një ndër masat kryesore është liria e shprehjes, por kohët e fundit kjo po cenohet shumë dhe kjo do të duhej të jetë shqetësuese për ministrin tuaj, sepse kemi mungesë të rezultateve, se kush po i sulmon dhe pse po i sulmon?

Po ashtu, kemi raste të shpeshta të dhunës në familje, andaj pyes se çka ka bërë konkretisht ministria dhe policia për parandalimin e kësaj dukurie?

E dimë se janë vetëm 100 ditë pune, por dua ta di se çka keni ndërmarrë për luftimin e korrupsionit brenda MPB-së dhe institucioneve të cilat janë në kuadër të ministrisë.

Sa i përket raportit tuaj të paraqitur në komision, mendoj se do të duhej të ishte më i thellë dhe më i detajuar, kur thuhet p.sh. 5 masa janë realizuar dhe 9 masa janë në realizim me vonesë, andaj kisha dashur ta di, cilat janë këto 9 masa, pse janë këto vonesa dhe kur priten të realizohen?

Ministri, tha se pyetja e fundit lidhet me pyetjen e parë të kryetares së komisionit, rreth plotësimit të masave dhe kriterëve. Në raport janë të paraqitura në mënyrë të detajuar, por pas përmbledhjes është çështje e akteve nënligjore që pasojnë pas miratimit të projektligjeve në Kuvend. Është e vërtetë që ka pasur ngecje teknike, por tani janë sanuar.

Lidhur me atë çka presim në vitin 2018, në realizimin e masave të MSA-së, personalisht tha se më së shumti pres që të gjitha këto të shihen në rrugë të aplikimit dhe realizimit të tyre, përveç në aspektin e makro-objektivave tona. Pra, është mirë që ato të realizohen në dokumentacione të gjitha këto statistika dhe përmbushjet e tyre dhe duhet ta kenë një reflektim shumë të shpejtë në jetën e përditshme të qytetarëve.

Sa i përket luftës kundër terrorizmit, si koordinator strategjik kundër terrorizmit, jemi në një situatë të vështirë në aspektin rajonal, makrorajonal, por jemi shumë të përgatitur dhe mjaft të avancuar në këtë aspekt. Është mjaft i rëndësishëm edhe riintegrimi i personave të kthyer nga lufta, dhe në këtë drejtim, jemi mjaft para të tjerëve, sepse kemi një program të mirë risocializimi për ata persona, sepse është e rëndësishme që ata persona mos ta konsiderojnë shtetin tonë si shtet armik dhe gjithë shoqëria duhet të angazhohet, që së paku të kemi një program orientimi dhe riintegrimi dhe risocializimi në shoqëri.

Sa i përket luftimit kundër drogës, Policia e Kosovës ka reaguar shumë shpejt dhe ka rezultate konkrete. Ky problem vërtet i takon policisë që ta luftojë, por është edhe problemi yni shoqëror, degradimi i vlerave tona shoqërore e ka sjellë këtë fenomen. Në këtë drejtim, duhet një veprim i të gjitha sferave shoqërore.

Sa përket pyetjes, lidhur me statusin e qytetarëve të Luginës së Preshevës, kjo çështje do të zgjidhet me Ligjin për të huajt, i cili pritet të miratohet në Kuvend.

Kurse, lidhur me menaxhimin e integruar të kufirit, tha se sa i përket Stanqiqit, aty është marrë leja për ndërtim, kurse lidhur me pikën kufitare në Kapi, personalisht jam marrë me çështjen e rrymës atje, është bërë kërkesa, por janë bërë gabime në procedura,

por KEDS ka dalë me disa kërkesa të reja, të cilat i kam analizuar dhe nuk i kam kuptuar, ku tani kërkohet që të gjithë pronarët e atyre trojeve ta japin një miratim përmes noterit, që të lëshohet rryma. Shtyllat janë të vendosura dhe kjo pikë kufitare duhet të lëshohet sa më shpejt në qarkullim.

Kurse, lidhur me pyetjen për qarkullimin e automjeteve të paregjistruara, theksoi se së pari duhet të shkohet me masa të buta e pastaj të kalohet në masa të forta, njëra prej prioriteteve të mia është ulja e aksidenteve në trafik, në përgjithësi dhe kjo lidhet pastaj edhe me çështjen e makinave të paregjistruara. Statistikat e kompanive të sigurimit dhe të policisë tani nuk përputhen dhe kam kërkuar një numër të saktë, por mendohet se 10 mijë deri 20 mijë mund të jenë të paregjistruara dhe një pjesë e tyre nuk janë në qarkullim, për shkak të vjetërsisë së tyre. Po ashtu, kam marrë vendim që t'u falen borxhet atyre që nuk kanë arritur t'i regjistrojnë makinat deri tani dhe do ta kenë një afat shumë të shkurtër që t'i regjistrojnë makinat e tyre dhe kjo pastaj do të rigjenerojë të hyra për MPB-në dhe do t'i lehtësohet puna policisë, që t'i identifikojnë më lehtë. Lidhur me marrjen në pyetje në polici, tha se personalisht do të merret me këtë çështje. Në vazhdim, tha se pasi jemi te policia, njoftoj komisionin se para një jave janë përmbushur kriteret dhe shtetet anëtare të EUROPOL-it e kanë miratuar kërkesën për fillimin e negociatave me Republikën e Kosovës dhe Policinë e Kosovës për fillimin e negociatave në veçanti për nënshkrimin e marrëveshjes për bashkëpunim dhe kërkoj nga ju, që të loboni në anëtarësim edhe në organizatat tjera.

Kurse, lidhur me çështjen e shtetësisë së qytetarëve tanë që jetojnë në Turqi, që e trashëgojnë nga njëri prind, ajo është e rregulluar me ligj.

Fikrim Damka, ndërhyri dhe sqaroi se ligji është në rregull, por me disa udhëzime administrative janë vështirësuar shumë kriteret, p.sh. kërkohet që të ndërrohet mbiemri në Turqi dhe të përshtatet mbiemri, të cilin e ka pasur para 50 viteve në Kosovë e që është e pamundur, ka edhe shumë e shumë raste të tjera që mund t'i dëshmojë me dokumente.

Ministri, tha se do t'i shohim kriteret, të cilat janë futur në udhëzime administrative, se ndoshta ka një arsye pse ato ekzistojnë dhe absolutisht ata që i plotësojnë kushtet do ta marrin dhe kanë të drejtën ta marrin shtetësinë, pra do të merremi me këtë çështje barabartë për të gjithë.

Kurse, lidhur me pyetjen për ndaljen dhe arrestimin e deputetëve, tha se sa jam në dijeni, janë bërë disa bisedime rreth mënyrës së ndaljes së deputetëve dhe propozime të takohemi me deputetë dhe të bëhet përcjellja e tyre me gjyq, por nuk është pranuar dhe vendimet e gjyqit duhet të respektohen dhe operacionet policore duhet të ekzekutohen dhe më vjen keq që ka ndodhur ajo.

Nuk ka drejtësi selektive dhe të diskriminuar për askënd dhe kjo lidhet edhe me rastin Dehari, që për mua është një tragjedi e rëndë familjare dhe e di që është duke u bërë një hetim edhe nga ekspertët zviceranë, shpresoj që e vërteta do të dalë sa më shpejt.

Sa i përket sigurisë nëpër burgje, tha se një pjesë e përgjegjësive i takon edhe Ministrisë së Drejtësisë. Ne jemi duke u marrë edhe me çështjen e radikalizmit në burgje dhe

çështjeve tjera. Siguria në burgje absolutisht duhet të respektohet si parim i të drejtave dhe lirive të njeriut.

Lidhur me prostitucionin, duke u bazuar në statistikat që prezantohen me një aktivitet tjetër ekonomik e pastaj zhvillohet krejt diçka tjetër, ekziston kjo dukuri dhe kjo pastaj lidhet edhe me trafikimin e qenieve njerëzore, që është prioritet i ministrisë, luftimi i këtij fenomeni negativ, ku përkrahje kemi nga OSBE-ja, e cila, po ashtu e ka si prioritet. Sa i përket fenomenit të dhunës në familje, po ashtu është problem më i gjerë shoqëror dhe përdorimi i narkotikëve dhe përhapja e prostitucionit, ne kemi probleme si shoqëri, por të gjitha shoqëritë në tranzicion i kaplon, dikush reagon më herët, dikush më vonë. Mendoj se nuk jemi vonë të reagojmë dhe duhet ta ngremë nivelin e vlerave të të gjitha institucionet, por ne që merremi me politikë, mos t'i degradojmë vlerat, sepse ka më shumë dhunë sesa raportohet. Përgjegjësi të madhe, në këtë drejtim, kanë edhe mediat. Sa i përket luftës së korrupsionit u përmenden disa procese që kanë ndodhur atëherë kur nuk isha ministër, por përballem në kohën e fundit me çështjen e pasaportave, për ta mbyllur këtë marrëveshje, jam marrë personalisht me dhe kemi arritur ta mbyllim rastin, sepse e kemi humbur në arbitrazh, sepse kanë qenë të orkestruara në mënyrë perfekte të gjitha gjërat dhe mjetet e kursyera gjatë bisedimeve dhe dje ia kam destinuar policisë që t'u ndahen secilit pjesëtar për festat e fundëvitit.

Lidhur me sulmet ndaj gazetarëve, kemi pasur raste sivjet, por po mundohemi t'u ofrojmë mbrojtje atyre që e kërkojnë.

Lidhur me sulmet ndaj gazetarëve, ia dha fjalën drejtorit të policisë, i cili tha se kemi kontakte të shpeshta me kryetarin e Shoqatës së Gazetarëve. Së fundmi, kemi vendosur që të gjitha rastet që kanë të bëjnë me gazetarët, të trajtohen në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë, e jo në stacionet policore, si më parë. Po ashtu, e kemi një qasje më proaktive edhe nga Prokuroria e Shtetit, sepse kanë caktuar prokurorët kompetentë, që të kujdesen për gazetarët.

Policia, në nëntor, ka ndërmarrë një aksion ku janë kontrolluar 30 lokale, por ka rezultuar që vetëm 4 janë mbyllur.

Sa i përket numrit të policëve në Dragash, numri i policëve është i mjaftueshëm. Të gjitha rastet trajtohen në mënyrë profesionale. Është e vërtetë që kemi të bëjmë me një konfiguracion të terrenit shumë të vështirë dhe kufijtë janë të hapur në të gjithë Kosovën. Po ashtu, ka raste të kalimit ilegal të kufirit dhe kemi arrestuar disa prej tyre.

Milaim Zeka, lidhur me lirinë e shprehjes, tha se në krahasim me vendet evropiane, askund nuk ka liri më të shfrenuar të shprehurit se në Kosovë, sa i përket sulmeve ndaj gazetarëve 90% të gazetarëve e sulmojnë vetveten, kurse sa i përket perceptimit të keq që është përhapur ndaj policisë, përgjegjësi të madhe kanë disa deputetë dhe disa forca politike. Sepse shumë herë e kanë barazuar me policinë e Millosheviçit, por policia vetëm i zbaton urdhrat dhe rregullat.

Në vazhdim, tha se dëshiron që ministrit t'i japë disa rekomandime si deputet.

1. Të nxjerrë një udhëzim administrativë për një sjellje të veçantë të policisë, në raport me deputetët, sepse ne si deputetë, nuk marrim iniciativë me e rikthye imunitetin tonë për të ndryshuar ligjin, sepse nuk jemi deputetë në praktikë.
 2. Për të qenë efikasiteti më i madh në punë, duhet të rritet rroga e policit në 800€ dhe hetuesit në 1500€.
 3. Të ndryshohet që mos të kemi regjistrimin e veturave çdo vjet por së paku çdo dy vjet dhe të thjeshtësohen procedurat për regjistrimin e veturave, sepse janë të ndërlikuara.
- Në fund, kërkoj nga drejtori që kur të dalin nëpër shkolla në fushata kundër drogës dhe dhunës në familje, të ftohen edhe deputetët.

Fatmire Kollçaku, tha se kishte një rekomandim, pasi që u tha se policia, në nëntor, ka ndërmarrë një aksion ku janë kontrolluar 30 lokale, por ka rezultuar që vetëm 4 janë mbyllur dhe doli konstatimi im, në bazë të disa statistikave tuaja, që pjesa dërmuese në këto lokale kanë qenë nga Shqipëria dhe Kosova dhe krejt pak nga vendet tjera, që është dukuri shqetësuese. Shpresoj që hetuesit tuaj e kanë për detyrë ta kenë parasysh që viktimat që shfrytëzohen aty, frikësohen dhe nuk guxojnë thonë të vërtetën, sepse iu konfiskohet pasaporta dhe varfëria e skajshme i detyron ato të zhyten në këto ujra dhe mbesin viktimat të përhershme, sepse shantazhohen.

Çështja tjetër, kur thashë se kemi drejtësi selektive dhe drejtësi për pakicë, kemi filmime publike, ku ministri gjuan me armë në një ambient të mbyllur, ku rrezikohen edhe ata që janë aty dhe ata jashtë. Kjo është skandaloze dhe ende nuk e di se a është ngritur si rast, ndoshta është ngritur, por ta shohim sesi ka për t'u ndëshkuar, kurse janë ndëshkuar deputetët për gazin lotsjellës që është gjuajtur në një ambient super të ventiluar dhe askush nuk është penguar të dalë nga salla.

E kam një propozim konkret dhe nuk e di, si polici, a keni pasur fushata vetëdijesuese për maturanët që janë në vitin e fundit të shkollës së mesme dhe vitin tjetër janë pretendues për të marrë patentë shoferin? Në këtë drejtim, është shumë me rëndësi që në fushata e vetëdijesimit të përfshihen të gjithë maturanët dhe policia, me filmime të aksidenteve, t'ju tregojnë të rinjve se çfarë pasojash do të kenë ata në tejkalimin e shpejtësisë, sepse kryesisht ata që provokojnë aksidente janë të moshës së re.

Pastaj, çështje tjetër është bashkëpunimi me autoshkolla. Mendoj se është tepër me rëndësi, sepse ende është pikëpyetje qysh jepen ato provime, nuk përfshihen në pjesën edukative dhe nuk e kanë obligim për t'i ndjekur ligjëratat, që është pjesë e rëndësishme dhe po ashtu pretenduesit për të marrë patentën duhet t'i nënshtrohen pandërprerë, në mënyrë vizuale, pasojave të një aksidenti, dhe si pasojë e kësaj, është rritur shumë numri i aksidenteve në trafik.

Andaj, është mirë që të vazhdojë bashkëpunimin e mirë me Institutin Kombëtar dhe të jetë prioritet i ministrisë çështja e vetëdijesimit dhe parandalimit të aksidenteve.

Ministri, tha se është plotësisht dakord me parafolësen, sepse ajo duhet të hyjë si kusht për marrjen e licencës për ngasjen e makinës, por kjo është në kompetencë të Ministrisë së Infrastrukturës.

Shaban Guda, drejtor i Departamentit për Kufi nga Policia e Kosovës, lidhur me pikën e kalimit në Stanqiq, tha se është e vërtetë që është zgjatur koha e ndërtimit, por është një pikë e përbashkët mes Kosovës dhe Maqedonisë. Pala kosovare i ka kryer të gjitha obligimet, kurse pala maqedonase ka mbetur që të marrë një leje për ndërtim në pjesën e saj në vijën kufitare.

Sa i përket Dragashit, ne e kemi një stacion policor që e mbulon atë pjesë të kufirit dhe kemi marrëveshje të përbashkëta të patrullimit me Shqipërinë dhe Maqedoninë, në pjesë të kufirit, bashkërisht, dhe këtë vit, deri më tani kemi pasur vetëm dy raste të lajmëruara. Kurse, lidhur me pikën kufitare në Restelicë, në kufi me Maqedoninë, tha se ka qenë i hapur, por është mbyllur në vitin 2010, sepse me muaj të tërë nuk ka kaluar askush.

Kryetarja, falënderoi ministrin, me bashkëpunëtorët, për raportimin e detajuar, falënderoi edhe policinë që ka qenë shumë në nivel të detyrës gjatë vitit 2017, brenda institucionit të Kosovës, sepse kemi qenë pjesë e një situatë kaotike.

Kërkoj nga drejtori i policisë, që të dërgojë një raport më të detajuar të rastet që janë duke u hetuar, masat që janë marrë për narkotikë dhe raporti t'u shpërndahet deputetëve.

Ministri, po ashtu falënderoi dhe ftoi anëtarët e komisionit që të shkojnë në ministri dhe të shkëmbehen idetë dhe të diskutojnë për temat që janë shumë me interes për qytetarët e Kosovës.

4. Shqyrtimi i Projektligjit nr.06/L-019 për Standardizim, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së

Kryetarja, lidhur me këtë projektligj, lexoi opinionin ligjor me përputhshmërinë e tij me legjislacionin e BE-së. Çështja e standardizimit është e rregulluar me legjislacionin e përgjithshëm dhe projektligji është paraparë me PKZMSA 2017-2021, përkatësisht në kapitullin e parë të Acquis. Po ashtu, konstatoi se projektligji, së bashku me amendamentet e Komisionit funksional, nuk cenon rregullat e përgjithshme të legjislacionit të BE-së dhe mund të rekomandohet për miratim në Kuvend. Lidhur me këtë projektligj, hapi debat.

Kryetarja konstatoi se komisioni, me shumicë votash, nxori këtë:

Rekomandim

Projektligjit nr.06/L-019 për Standardizim, me amendamentet e Komisionit funksional, nuk është në kundërshtim me legjislacionin e BE-së, përkatësisht me acquis e BE-së.

5. Të ndryshme

Kryetarja, në këtë pikë, pyeti anëtarët nëse kanë për të diskutuar ndonjë çështje.

Milaim Zeka, propozoi që për demarkacion, te Gjykata Speciale, veteranet e luftës, gjërat për politikë të jashtme që i prekin interesat kombëtare mu krijua një grup i deputetëve që mendojmë një soj sepse nuk mundemi çka do që vjen vetëm me kundërshtuar, do të ishte mirë që pas vitit të ri, ta marrim një iniciativë, sepse ma merr mendja se loja që po bëhet me Gjykatën Speciale është e rrezikshme për pavarësinë e Kosovës, sepse në fillim kërkesa ka qenë që të akuzohen serbë, shqiptarë, pra të gjithë ata që kanë bërë krime brenda territorit të Kosovës, kurse tani ka dalë një bela tjetër. Si deputet, mendoj se ne duhet të jemi të koordinuar, duhet të marrim iniciativë për të ndryshuar ligjin për kthimin e imunitetit të deputetëve apo qoftë edhe Kushtetutën, sepse nuk më vjen mirë të shoh deputetët të prangosur, pavarësisht që janë edhe kundërshtarë. Po ashtu, edhe te liria e fjalës, ne duhet ditur që pjesa dërmuese e gazetarëve janë duke spekuluar dhe akuzuar dhe poshtëruar deputetët.

Armend Zemaj, tha se tre elemente që i përmendi parafolësi lidhen kryesisht me funksionin e Komisionit për Integritet Evropian. Në raport me integritet evropian, ndoshta mënyra se si po i shtroni në mënyrë të gjeneralizuar, është e vërtetë se ka histori, ka memorie institucionale që i përmendi z. Zeka, sidomos ato që kanë të bëjnë me interferimin gjyqësor dhe imunitetin e deputetëve, që ndërlidhen me kërkesat e BE-së, herë pas here për shtetet që janë në tranzicion, çfarë lloj imuniteti u japin përfaqësuesve të vet, si në Kuvend dhe në Qeveri, dhe një çështje që neve mbetur si presion i publikut, ka qenë ligji për mbrojtjen e informacioneve të gazetarisë, që dallon prej vendeve tjera, në aspektin çfarë ka ardhur te ne në Kosovë, Kodin penal si e trajtojnë në vendet demokratike evropiane. Lidhur me këto 3 çështje, jo që nuk ka kapacitet komisioni ynë, por do të duhej një dakordim pak më i madh dhe jemi në fazën e shqyrtimit të rregullores, dhe për këto 3 gjëra, duhet një logjikë më e shëndoshë dhe një intervenim më i shpejtë, pra kemi nevojë për qartësim të imunitetit funksional, sepse kjo po mungon dhe po keqpërdoret. Kurse, sa i përket inicimit të formimit të grupeve të reja, mendoj se i tejkalojnë kompetencat tona se jemi përfaqësues politikë dhe sido që të jetë, këto 3 pika, në bazë të fushëveprimit, ndoshta kishim mundur t'i shtyjë brenda këtij mandati.

Milaim Zeka, shtoi se nëse duam ta ushtrojmë funksionin tonë si deputetë, duhet t'i bëjmë ndryshimet ligjore, për të na dhënë mundësinë me qenë deputetë.

Ahmet Isufi, theksoi se çështja e imunitetit duhet të rregullohet, nëse deputeti nuk ka të drejta dhe detyrime të bazuara në standardet që i kanë vendet në shtetet e rajonit, si deputetë e marrim iniciativën, ta bëjmë ligjin dhe t'i për afrojmë disa gjëra, që të funksionojmë si shtet.

Kurse, te Gjykata Speciale, kur është iniciuar, është thënë që selinë ta ketë, një pjesë në Kosovë dhe një pjesë në Hagë, por kur është përfunduar, ka ndodhur për të qenë absolutisht jashtë dhe trajtimi bëhet vetëm ndaj një kategorie. Para ligjit, jemi të gjithë

të barabartë dhe kushdo që ka bërë krime duhet të dënohet. Këtu kanë ndodhur defektet, u ndryshua krejt ligji dhe u miratua në Kuvend.

Duhet të shohim realisht gjendjen, dhe para se të ndodhin gjërat, duhet të jemi të kujdesshëm, e jo kur po ndodhin të bëhemi pishman, është problem me u kthye diçka mbas, por në fund të fundit, ne duhet të sillemi si shtet, dhe si deputetë, duhet ta shikojmë atë të përgjithshmen.

Mbledhja përfundoi në orën 12:20.

Përgatitur nga:

Njësia për mbështetjen e komisionit.

Kryetare e misionit,

Znj. Blerta Deliu-Kodra